

KUSHTET DHE AFATET E PROMOCIONIT „Samsung QLED+ 80litra Kastrati “

1. Samsung Electronics Austria GmbH, Austria, Vienna, Praterstrasse 31/14 Obergeschoss (më poshtë referuar si: Samsung), organizon promovionin e televizorëve Samsung QLED. Me blerjen e Samsung Kled ju merrni kuponat për karburant të lirë siç është përcaktuar në dispozitat e tjera të Kushteve dhe Afateve, pas përmbushjes së detyrimeve dhe kushteve të përcaktuara në këto Kushte dhe Afate.

Të gjithë blerësit e televizorëve QLED, të blerë gjatë periudhës nga 5 qershori 2019 deri më 31 korrik 2019, do të marrin një dhuratë në përputhje me Kushtet dhe Afatet.

Dhuratat që do të marrin blerësit janë si më poshtë:

Për blerjen e televizorit QLED, dhuratat do të jenë: kuponat për karburant të lirë (80 litra)

Në pikën 7 të Kushteve dhe Afateve, është lista e modeleve ose kodet e modelit të televizorëve Samsung QLED që janë objekti i këtij promovioni.

Numri i dhuratave është i kufizuar dhe do të shpërndahet tek klientët të cilët regjistrohen deri në mbarimin e mallit në gjendje.

2. QËLLIMI DHE KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË PAJISJES

Klientët fundorë që kanë blerë një televizor Samsung, siç përcaktohet në pikën 1 të Kushteve dhe Afateve, përkatësisht në periudhën e përcaktuar në pikën 1 të Kushteve dhe Afateve do të regjistrohen për qëllim të pjesëmarrjes në këtë promovion duke dërguar një e-mail në adresën ce.promotion@samsung.com. Regjistrimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga data e blerjes.

Në rast të përmbushjes së kushteve të referuar në pikën 1 të Kushteve dhe Afateve dhe regjistrimit të suksesshëm, blerësit do të marrin dhuratë pajisjen e përcaktuar në pikën 1 të Kushteve dhe Afateve deri në mbarimin e mallit në gjendje për dhurata. Pajisja dhuratë do të dërgohet në adresën e banimit pa përfshirë kostot e transportit brenda 30 ditë pune nga dita e përfundimit të regjistrimit.

3. KUSHTET E REGJISTRIMIT

Të gjithë blerësit në Republikën e Shqipërisë që blejnë televizorin Samsung QLED me kodin e modelit të përcaktuar në pikën 7 të Kushteve dhe Afateve kanë të drejtë të regjistrohen dhe marrin pjesë në këtë promovion, sipas kushteve të përcaktuara në Kushtet dhe Afatet, dhe vetëm me partnerët e mëposhtëm të Samsung:

Neptun AL, Globe, GoTech, AZA et.

4. PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË PAJISJES

Në mënyrë që blerësi i televizorit Samsung QLED të ketë mundësi të marrë pjesë në këtë Promocion dhe të ketë të drejtën e përfitimit të dhuratës siç përcaktohet në pikën 1 të Kushteve dhe Afateve, është e nevojshme që blerësi të regjistrohet në përputhje me dispozitat e tjera të Kushteve dhe Afateve.

Procedura e regjistrimit nënkupton dorëzimin e të dhënave personale të blerësit, të dhëna që janë të nevojshme për regjistrimin e suksesshëm. Të dhënat personale të blerësit që duhet të mblidhen janë: emri, mbiemri, adresa e e-mail-it të përdoruesit, adresa e saktë e banimit të blerësit (për dorëzimin e dhuratës), numri i telefonit (për ta kontaktuar në lidhje me dorëzimin e dhuratës) dhe një kopje të skanuar të mandat pagesës nga pika e shitjes për të konfirmuar regjistrimin.

Përveç të dhënave personale të lartpërmendura, për një regjistrim të suksesshëm, blerësi duhet t'i japë Samsung informacionin e mëposhtëm:

- modelin dhe numrin serial të pajisjes

Duke dërguar një e-mail në adresën e e-mailit të përmendur në pikën 2 të Kushteve dhe Afateve, blerësi i dorëzon Samsung të dhënat e tij/saj. Samsung do të verifikojë nëse data e blerjes është në përputhje me kushtet e referuar në pikën 1 të Kushteve dhe Afateve, dhe nëse janë përmbushur kushtet e tjera të përcaktuara këtu. Duke dërguar një e-mail, blerësi gjithashtu jep miratimin e tij/saj për të zbatuar këto Kushte dhe Afate dhe për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat personale të tij/saj në përputhje me këto Kushte dhe Afate.

Nëse data e blerjes është në përputhje me Kushtet dhe Afatet, dhe nëse kushtet e tjera të përcaktuara këtu janë përmbushur, dhurata e referuar në pikën 1 të Kushteve dhe Afateve do t'i dorëzohet blerësit në adresën e tij të banimit brenda 30 ditëve nga momenti i regjistrimit të suksesshëm, për të cilën blerësi do të njoftohet nëpërmjet e-mail-it të dërguar në adresën e e-mail-it të dhënë gjatë procesit të regjistrimit.

5. PËRDORIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Të dhënat personale të blerësve që dorëzojnë të dhënat e tyre tek Samsung në përputhje me Kushtet dhe Afatet do të mblidhen dhe përpunohen në përputhje me Politikën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Privatësisë të Samsung dhe Kushteve dhe Afateve, si dhe në përputhje me rregullat përkatëse të Republikës së Shqipërisë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Qëllimi për mbledhjen e të dhënave personale është përmbushja e kushteve për pjesëmarrjen në këtë promocion dhe përcaktimi i adresës për dorëzimin e dhuratës.

Të dhënat personale të blerësit që do të mblidhen në lidhje me promocionin do të vihen në dispozicion të subjekteve të mëposhtme:

- Samsung Electronics Austria GmbH Dega Zagreb , Radnicka cesta 37, Zagreb, Kroaci), në cilësinë e Drejtuesit të mbledhjes së të dhënave personale,
PUBLICIS ONE, Franklin Ruzvelt 37, 1000 Skopje, Macedonia në cilësinë e agjencisë dhe përpunuesve të të dhënave personale

Drejtuesi i mbledhjes së të dhënave personale dhe përpunuesi i të dhënave personale do t'i trajtojë të dhënat personale të mbledhura në përputhje me Politikën për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Privatësisë së Samsung, si dhe në përputhje me rregulloret përkatëse të Republikës së Shqipërisë, dhe nuk do t'ua zbulojë këto të dhëna palëve të treta.

Mbledhja e të dhënave personale në lidhje me këtë promocion është vullnetare. Nëse blerësi vendos të mos vërë në dispozicion të Samsung të dhënat e tij personale, blerësi nuk mund të marrë pjesë në këtë promocion.

Drejtuesi i mbledhjes së të dhënave personale, me kërkesë të zotëruesit të të dhënave personale, do të plotësojë, ndryshojë ose fshijë të dhënat personale nëse nuk janë të plota, të sakta ose të përditësuara, dhe nëse përpunimi i tyre nuk është në përputhje me ligjin.

6. E DREJTA PËR TË NDRYSHUAR KUSHTET DHE AFATET E PROMOCIONIT

Samsung ka të drejtë, në çdo kohë, mbi baza të arsyeshme, të bëjë ndryshime në Këto Kushte dhe Afate, dhe të angazhohet t'ju zbulojë ato pa vonesë. Nëse këto ndryshime kërkojnë modifikimin e kushteve të përdorimit të të dhënave personale, Samsung do të kërkojë miratimin e klientëve të cilët kanë vënë në dispozicion të Samsung të dhënat e tyre personale në lidhje me këtë promocion.

7. LISTA E MODELEVE QË JANË OBJEKT I PROMOCIONIT

QLED TV
QE65Q900RATXXH
QE75Q900RATXXH
QE82Q950RBTXXH
QE85Q900RATXXH

QE49Q60RATXXH
QE49Q65RATXXH
QE55Q60RATXXH
QE55Q65RATXXH
QE55Q70RATXXH
QE55Q80RATXXH
QE55Q85RATXXH
QE55Q90RATXXH
QE65Q60RATXXH
QE65Q65RATXXH
QE65Q70RATXXH
QE65Q80RATXXH
QE65Q85RATXXH
QE65Q90RATXXH
QE75Q60RATXXH
QE75Q70RATXXH
QE75Q85RATXXH
QE75Q90RATXXH
QE82Q60RATXXH
QE82Q70RATXXH
QE43Q60RATXXH